



Save the Children




Trajtimi i krizës klimatike dhe pabarazisë për fëmijët Përmbledhje e të dhënave për Shqipërinë



Hyrje

Shqipëria është një vend me të ardhura mesatare në Evropën Lindore, ku jetojnë 611,364 fëmijë. Ashtu si në shumë vende të tjera me të ardhura mesatare, pavarësisht rritjes ekonomike, vazhdon të ketë pabarazi midis familjeve bazuar tek të ardhurat dhe faktorë të tjerë, si gjinia, etnia dhe aftësia e kufizuar. Duke qenë një vend me të ardhura mesatare, Shqipëria nuk përfiton nga e njëjta mbështetje ndërkombëtare për familjet më të varfra, si ajo që është e disponueshme për vendet më të varfra. Kriza klimatike po i përshkallëzon këto pabarazi për fëmijët shqiptarë dhe ata duhet të përfshihen në vendimet që merren aktualisht dhe që do të ndikojnë jetën e tyre dhe jetën e brezave që do të vijnë.

Save the Children mbështeti Grupet e Drejtuara nga Fëmijët (GDF-të) për hartimin e një raporti të drejtuar nga fëmijët për mekanizmat e KDF-së lidhur me ndryshimet klimatike dhe çështjet mjedisore. Dy përfaqësues nga Grupet e Drejtuara nga Fëmijët në Shqipëri (një vajzë dhe një djalë), të mbështetur nga Zyra Kombëtare e Save the Children në Shqipëri, prezantuan përmbledhjen e raportit miqësor me fëmijët në takimin paraprak të mbajtur në shtator të vitit 2022, si pjesë e Procesit Alternativ të Raportimit të KDF-së për Shqipërinë. Ky raport trajton ndikimin që kanë ndryshimet klimatike te fëmijët.



Pabarazia ekonomike është si një sëmundje ... dhe është kërcënim i të drejtave të njeriut. Është një kërcënim i madh për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e sotëm... Në Shqipëri, pasuria është e përqendruar te shumë pak njerëz.’ - 17 vjeç, vajzë

Fëmijë që jetojnë në varfëri:

10%



Fëmijët e prekur nga risku klimatik:

96%



Fëmijët e prekur nga varfëria dhe klima:

9% (57,000)

1

A janë politikat klimatike në Shqipëri mjaftueshëm ambicioze dhe të përqendruara te fëmijët?

Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa për të adresuar ndryshimin klimatik dhe për të reduktuar emetimet e gazeve serë [GHG]. Në vitin 2017 Shqipëria ratifikoi Marrëveshjen e Parisit për Klimën. KKP-ja e Shqipërisë [Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar] sipas Marrëveshjes së Parisit përfshin synimin për të reduktuar emetimet e GHG-ve me 11.5% deri në vitin 2030, krahasuar me nivelet e vitit 2005.

Për sa i përket politikave të fokusuar te fëmijët, Shqipëria ka zbatuar programe që synojnë edukimin dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe adresimin e ndryshimit klimatik.

A është KKP-ja e ndjeshme ndaj fëmijës?	Disi e ndjeshme për fëmijën
A i identifikon KKP-ja fëmijët si një grup i cënueshëm?	Po
A bazohet KKP-ja në të drejta (të drejtat e njeriut dhe drejtësia ndër breza)?	Jo

Burimi: Observatori Klimatik 2021



‘Ndryshimi klimatik ka prekur ekosistemin tonë... shkencëtarët flasin për problemet e shtresës së ozonit. Akulli në polet e tokës po shkrin me shpejtësi... Njerëzit janë mësuar me temperaturat e vendeve ku jetojnë. Temperaturat në rritje mund të jenë të vështira për t’u përballuar.’ - 18 vjeç, djalë

2

A po investon Shqipëria te fëmijët dhe a po sigurohet që asnjë fëmijë të mos mbetet pas?

Programi “Askush të mos mbetet pas” (LNB) synon të përmirësojë shërbimet në Shqipëri dhe të nxisë pjesëmarrjen e grupeve të cënueshme në vendimmarrje që ndikojnë në jetën e tyre.

Ndërhyrjet e programit synojnë persona vendorë dhe përqendrohen veçanërisht në personat me aftësi të kufizuara, si dhe komunitetet rome dhe egjiptiane që kanë nevojë për mbrojtje dhe kujdes social. Në të njëjtën kohë, projekti mbështet institucionet kombëtare, bashkitë dhe ofruesit vendorë të shërbimeve të ofrojnë shërbime më efektive dhe efikase dhe të promovojnë përfshirjen sociale.

	A është progresi gjithëpërfshirës?	A janë të gjitha grupet në rrugën e duhur për të përmbushur synimet e OZHQ-së?
Prapambetja në rritje (OZHQ2)	✓	✗ Asnjë grup
Vdekshmëria nën moshën pesë vjeç (OZHQ 3)	✓	✓ Të gjithë grupet
Jashtë sistemit shkollor, fillore (OZHQ 4)	✓	✓ Vetëm disa grupe

SHPENZIMET NË SEKTORËT SOCIALE (% PBB)		
Shëndetësia	Arsimi	Mbrojtja sociale
3%	3.4%	1.3%

Burimi: Raporti Global i Shpenzimeve Shëndetësore OBSH 2020, UNESCO 2020, Raporti Global i Mbrojtjes Sociale 2020-2022/FMN 2020



3

A po bën Shqipëria mjaftueshëm për të mbështetur fëmijët e prekur nga kriza?

Sipas "Analizës së situatës së fëmijëve dhe adoleshentëve në Shqipëri" (raport i UNICEF-it i vitit 2021), pengesa më e madhe në praktikë për realizimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri është refuzimi i vazhdueshëm i qeverisë për të investuar te shërbimet për fëmijët, madje edhe brenda kufizimeve të financave kombëtare.

Për vite me radhë, qeveritë kanë nënfinancuar shëndetësinë, arsimin, shërbimet për mbrojtjen dhe mirëqenien, duke arritur një nivel nën atë të shteteve anëtare të OECD-së, shteteve anëtare të BE-së, si dhe shteteve të tjera në rajon. Kjo prirje është vëzhguar edhe pas rritjes së Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe pasi vendi mori statusin e një vendi me të ardhura mbi mesataren.

Kjo mungesë ka shkatërruar në mënyrë të pashmangshme infrastrukturën, ka penguar novacionin, ka ulur standardet


e cilësisë, ka nxitur korrupsionin në nivele të ulëta dhe ka ulur gjithnjë e më shumë përshtatshmërinë e shërbimeve me qëllimin përkatës. Me shumë gjasë, vitet e ardhshme do të jenë mjaft të vështira për fëmijët dhe familjet, pasi vendi po përballet me një rënie të pritshme të PBB-së si rrjedhojë e pandemisë botërore. Ka gjasa që shërbimet për fëmijët, të cilat nuk janë të konsoliduara, të reagojnë me vështirësi, dhe është e rëndësishme që të garantohet jo vetëm mosdëmtimi i mëtejshëm i buxheteve lidhur me fëmijët, por edhe të përmbyset modeli kombëtar i nëninvestimit për fëmijët, dhe të mbrohen, të zgjerohen dhe të përmirësohen shërbimet për fëmijët dhe familjet. Në të njëjtën kohë, pandemia ka nxjerrë në pah kapacitetin real të qeverisë për të reaguar, si dhe ka evidentuar qartësisht pikat e forta dhe të dobëta të shërbimeve të ndryshme lidhur me fëmijët.

TË DHËNAT PËR NIVELIN E PËRGATITJES PËR FATKEQËSITË

Indeksi INFORM - mungesa e kapaciteteve përbaluese (0 vlerësimi më i mirë, 10 më i keq)



Kapacitetet institucionale përfshijnë reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe qeverisjen



Infrastruktura përfshin komunikimin, infrastrukturën fizike, aksesin në sistemet e shëndetësisë

Burimi: Inform Risk Index 2023

A KA SHQIPËRIA PLANE PËR PËRSHTATJEN E KLIMËS NË KUADËR TË NDJESHMËRISË NDAJ FËMIJËVE?		
A ka adaptuar KKP-ja angazhime të ndjeshme ndaj fëmijëve për:		
	Shëndetësinë	Jo
	Sigurinë ushqimore dhe ushqyerjen	Jo
	Arsimin	Jo
	Mbrojtjen Sociale	Jo

Burimi: Observatori Klimatik 2021

4

A mbështeten të drejtat e fëmijëve për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje?

Shqipëria ka miratuar një legjislacion kombëtar që mbron të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje, që përfshin Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, që njohin rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve në proceset e vendimmarrjes që prekin jetën e tyre dhe sigurojnë mekanizmat për të garantuar pjesëmarrjen e tyre. Këshilli Kombëtar i Fëmijëve në Shqipëri është një ndër mekanizmat kryesorë për promovimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në Shqipëri. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, ka ende sfida sa i përket mbështetjes së plotë të të drejtave të fëmijëve për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje në Shqipëri.

PJESËMARRJA E FËMIJËVE NË POLITIKËBËRJEN PËR KLIMËN	
Në përgjithësi procesi i KKP-së ka qenë gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës	Po
KKP-ja i sheh fëmijët si nxitës të ndryshimit	Jo

Hapësira qytetare i referohet mjedisit që i mundëson shoqërisë civile të gëzojë lirinë e shoqërimit, tubimit paqësor dhe shprehjes; ajo duhet të respektohet në politika, ligje dhe praktikë, për të mbrojtur këto të drejta themelore. Një hapësirë qytetare e hapur dhe pluraliste është kushti paraprak për qëndrueshmërinë e zhvillimit dhe paqes.

Masa CIVICUS për hapësirën qytetare.	Shkurtuar
--------------------------------------	-----------

A po merr Shqipëria mjaftueshëm mbështetje për të trajtuar krizën klimatike dhe të pabarazisë?

Për sa i përket mbështetjes, Shqipëria ka marrë financime dhe mbështetje teknike nga organizata ndërkombëtare, si Bashkimi Evropian, Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara dhe Banka Botërore, ndër të tjera. Në tërësi, trajtimi i krizës së klimës dhe pabarazisë në Shqipëri kërkon mbështetje të vazhdueshme dhe ndërhyrje të synuara nga qeveria shqiptare dhe organizatat vendase dhe ndërkombëtare. Këtu përfshihet dhe promovimi i kulturës së respektit për të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat e fëmijëve dhe grupeve të marginalizuara, dhe garantimi se këto grupe do të përfshihen në mënyrë kuptimplote në zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve.



REKOMANDIME KYÇ

1. Përmirësojë shërbimet thelbësore për fëmijët dhe t'i përgjigjet krizës së klimës dhe pabarazisë në një mënyrë që njeh ndikimet e saj shumëdimensionale. Kjo përfshin garantimin që planet e emergjencës të ndihmojnë familjet që përballen me fatkeqësitë natyrore, aksesin në mbrojtjen sociale, arsim, shëndetësi dhe shërbimet për shëndetin riprodhues, dhe të parandalojë diskriminimin me bazë gjinore apo çdo bazë tjetër.
2. Kriza klimatike është emergjencë dhe duhet trajtuar si e tillë. Kjo nënkupton prezantimin e publikut me fushata informimi për të edukuar të gjithë sektorët, përfshirë shkollat, komunitetet, sektorin privat dhe median, mbi ndikimin shumëdimensional të ndryshimit të klimës dhe rolin e tyre thelbësor në trajtimin e krizës klimatike.
3. Zhvillojë politika për klimën dhe për pabarazinë, që njohin ndikimet ekonomike afatgjata dhe ndikimet e tjera të fatkeqësive klimatike, veçanërisht në pjesën më të madhe të grupeve të përjashtuara. Ndërhyrjet duhet të shkojnë përtej mbrojtjes sociale dhe pasojave të menjëhershme të krizave në mbijetesën e familjeve drejt ndikimit afatgjatë të niveleve të dhunës me bazë gjinore, aksesit në ushqim dhe largimit të hershëm nga shkolla.
4. Punojë me të gjitha palët e interesit (duke përfshirë fëmijët) për të ofruar një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj ndryshimit të klimës, që garanton se ata do të mbështeten në dëshmi, arsim dhe kapacitete për të ndërmarrë veprime efektive.

PP Pabarazia ka ekzistuar gjithmonë në Shqipëri. - 18 vjeç, vajzë

PP Stinët kanë ndryshuar dhe po humbasin karakteristikat e tyre... kemi temperatura shumë të larta në vjeshtë dhe temperatura shumë të ulëta në pranverë. Kjo po ndodh në Shqipëri, por edhe në të gjithë botën... Nuk mund të bëjmë më dallimin ndërmjet stinëve dhe kjo po bëhet gjithmonë e më shqetësuese ditë pas dite. - 18 vjeç, djalë



Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami); PO Box 8185, Tiranë - Shqipëri;
Tel: +355 4 2261840/ 4 2261929; E-mail: info.albania@savethechildren.org
<https://albania.savethechildren.net>

f Savethechildrenal

SaveChildrenAlb

savethechildrenalbania

